EKSTRAKT NGA KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË JETËS EVOLUTIVE

I.PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

1. Në këto kushte të përgjithshme termat e përdorur kanë kuptimin e mëposhtëm:

1.1. **"Sigurues",** nënkupton Shoqërinë e Sigurimit, me të cilën lidhet kjo kontratë sigurimi dhe e cila do t'i paguajë Përfituesit përfitimet e përcaktuara në kontratën e sigurimit.
1.2. **"Kontraktues",** nënkupton Personin fizik ose juridik që lidh Kontratën e Sigurimit me Siguruesin.
1.3. **"I siguruar",** nënkupton individin, jeta e të cilit sigurohet dhe me vdekjen e të cilit lidhet pagesa e shumës së sigurimit, për të cilën është rënë dakord.
1.4. **"Përfitues",** nënkupton personin, që përfiton shumën e rënë dakord në kontratë.
1.5. **"Policë sigurimi",** nënkupton dokumentin që vërteton lidhjen e Kontratës së Sigurimit.
1.6. **"Prim sigurimi",** nënkupton shumën, të cilën i Siguruari/Kontraktuesi është i detyruar t'i paguajë Siguruesit në bazë të kontratës për sigurimin e jetës evolutive.
1.7. **"Periudha e Sigurimit",** nënkupton kohëzgjatjen e kontratës së sigurimit.
1.8. **"Periudha e Pagesës së Primit",** nënkupton periudhën e përcaktuar në policën e sigurimit, gjatë së cilës paguhen primet. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se periudha e sigurimit.
1.9. **"Ngjarja e sigurimit",** nënkupton vdekjen e të siguruarit, që ndodh brenda periudhës së sigurimit dhe sipas kushteve të kësaj kontrate sigurimi.
1.10. **"Shuma e sigurimit",** nënkupton shumën e rënë dakord, për të cilën lind detyrimi i Siguruesit i përcaktuar me kontratën e sigurimit/policën e sigurimit.

Neni 2
Produkti i sigurimit

1. Kontraktuesi /i Siguruari i paguan Siguruesit primin dhe Siguruesi, nëse ndodh ngjarja e sigurimit i paguan Përfituesit shumën e siguruar sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara.
2. Sipas këtyre kushteve të përgjithshme, kufiri minimal i personave për të hyrë në sigurim është 18 vjeç. Kufiri maksimal i personave për të hyrë në sigurim është 67 vjeç. Sigurimi përfundon kur i siguruari mbush 70 vjeç.
3. Të gjitha njoftimet, deklarimet dhe kërkesat e palëve kontraktuese duhet të paraqiten me shkrim dhe të respektojnë kushtet e përgjithshme të sigurimit.

Neni 3
Persona që nuk sigurohen

Siguruesi nuk ofron sigurimin për:

a) Personat që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi ose sëmundje mendore si skicofrenia, format maniako – depresive të gjendjes paranoiake apo sindromat organike – celebrale.
b) Personat që kërkojnë kujdes të përhershëm;
c) Personat e paaftë për punë;
d) Personat që kanë mbushur moshën 68 vjeç në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit.
e) Personat që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç.

Neni 4
Rreziku i Mbuluar

Kjo kontratë mbulon rrezikun e humbjes së jetës së të siguruarit sipas kushteve dhe afateve më poshtë:

a. Në vitin e parë të sigurimit, do të mbulohet vdekja si pasojë e aksidenteve, sipas përkufizimit të aksidentit të dhënë në Nenin 6. Humbja e jetës për arsye të tjera, nuk mbulohet gjatë vitit të parë të sigurimit.
b. Në vitin e dytë të sigurimit, do të mbulohet vdekja si pasojë e aksidenteve, sipas përkufizimit të aksidentit të dhënë në Nenin 6 si dhe vdekja si pasojë e sëmundjeve të papritura sipas

përkufizimit të "Sëmundjeve të Papritura" të dhënë në Nenin 7. Humbja e jetës për arsye të tjera, nuk mbulohet gjatë vitit të dytë të sigurimit.

c. Mbas vitit të dytë të sigurimit, do të mbulohet vdekja nga çdo shkak, përveçse kur shkaku i vdekjes është përjashtim nga mbulimi në sigurim sipas përkufizimeve të dhëna në Nenin 13 "Përjashtime të mbulimit në sigurim".

Neni 5
Pëkufizimi i Aksidentit

1. Aksident do të konsiderohet një ngjarje e papritur e pavarur nga vullneti i të siguruarit dhe me pasojë direkte të jashtme në trupin e të siguruarit.

2. Vdekja aksidentale do të konsiderohet humbja e jetës e të siguruarit si pasojë e aksidentit sipas përcaktimeve të këtij neni. Vdekja aksidentale duhet të ndodh brenda 12 muajve nga data e aksidentit.

Neni 6
Pëkufizimi i Sëmundjeve të papritura

1. Do të konsiderohet "sëmundje e papritur" ndryshimi i gjendjes shëndetësore të të siguruarit që nuk shkaktohet nga aksidenti, por që ka një natyrë të papritur dhe të paparashikueshme, ndodhja e së cilës është e pavarur nga vullneti i të siguruarit, ndodh brenda periudhës së sigurimit dhe ka shfaqje të simptomave që e bëjnë të padiskutueshme diagnozën nga një mjek i licencuar për të ushtruar profesionin e tij.
2. Për efekt të kësaj kontrate sigurimi, do të mbulohet vdekja e të siguruarit që shkaktohet nga një prej sëmundjeve të papritura të mëposhtme:

a) **Meningiti infektiv**, i cili është inflamacioni akut i membranave mbrojtëse që mbështjellin trurin dhe kordat spinale të quajtur meningjet.
b) **Encefaliti infektiv,** i cili është sëmundja infektive akute që shkakton inflamacion akut të trurit.
c) **Aksident cerebralo-vaskular,** i cili është bllokimi apo ngushtimi i arterieve cerebrale dhe paracerebrale,shkaktuar nga një rupture cerebro-vasulare ose tromboze.
d) **Ruptura e aortës,** e cila është pasojë e keqformimeve të lindura të aortës ose si pasojë e një aterome aortike.
e) **Embolia pulmonare,** e cila ndodh papritur dhe e palidhur me ngjarje të mëparshme.
f) **Pankreatiti akut** (jo nga alkooli), i cili është inflamacion akut i pankreasit, shkaku i të cilit nuk lidhet me konsumin e alkoolit.
g) **Peritoniti akut,** i cili është i palidhur me historik të sëmundjeve abdominale dhe i cili nuk ka kërkuar më parë trajtim mjekësor apo ndërhyrje kirurgjikale.
h) **Miokarditi infektiv akut,** i cili është sëmundja infektive akute e cila shkakton inflamacion të muskulit të zemrës (miokardit), pa ngjarje të mëparshme dhe i cili nuk ka kërkuar më parë trajtim mjekësor.
i) **Infarkti i miokardit,** i cili ndodh papritur dhe i palidhur me ngjarje të mëparshme dhe nuk ka kërkuar më parë trajtim mjekësor.
j) **Hepatitis fulminant,** i cili është hepatit akut me pasoja të papritura dhe të rënda në mëlçi.

II. VLEFSHMËRIA E POLICËS SË SIGURIMIT

Neni 7
Afati, hyrja në fuqi e sigurimit

1. Siguruesi lëshon policën e sigurimit në bazë të kërkesës së Kontraktuesit ose të Siguruarit.
2. Polica e Sigurimit lëshohet për një afat kohor të paracaktuar.

III. PRIMI DHE SHUMA E SIGURIMIT

Neni 8
Primi i sigurimit

1. Siguruesi përcakton primin e sigurimit vjetor bazuar në moshën, gjininë e të Siguruarit, shumën e siguruar.
2. Primi i sigurimit paguhet në monedhën në të cilën është shprehur shuma e sigurimit.

3. Primi i Sigurimit konsiderohet i paguar ditën kur pagesa është regjistruar në llogarinë e Siguruesit.
4. Çdo kërkesë për shtyrjen e pagesës së primit duhet të miratohet me shkrim nga Siguruesi.

Neni 9
Shuma e Sigurimit

Palët bien dakord për përcaktimin e Shumës së Sigurimit në varësi të tarifave të Siguruesit, moshës së të Siguruarit, veprimtarisë profesionale dhe periudhës së sigurimit. Shuma e sigurimit mund të jetë e pandryshueshme përgjatë gjithë periudhës së sigurimit, ose zbritëse në çdo përvjetor të policës së sigurimit. Në rast se shuma e sigurimit është zbritëse, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, Siguruesi ka detyrim të paguajë jo më tepër se shuma e sigurimit për vitin përkatës.

Neni 10
Mos pagesa e primit vjetor

1. Nëse primi vjetor (primi i dytë e në vazhdim ose kësti i dytë e në vazhdim) nuk është paguar brenda një periudhe 15 ditore nga data e detyrueshme për pagesë sipas pikës 3 të nenit 9, atëherë sigurimi ndërpritet.

IV. DETYRIMET E SIGURUESIT

Neni 11
Përfitimet e Pagueshme

1. Siguruesi detyrohet të paguajë përfitimet e pagueshme të përcaktuara në Policën e Sigurimit në mbështetje të këtyre kushteve të përgjithshme në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit para përfundimit të periudhës së sigurimit.
2. Në rastet e përfitimit për vdekjen si pasojë e një sëmundje, Siguruesi ka të drejtë të shqyrtojë të dhënat mjekësore e personale të të Siguruarit.

V. PËRJASHTIME DHE KUFIZIME TË DETYRIMEVE TË SIGURUESIT

Neni 12
Përjashtime të mbulimit në sigurim

Për efekte të kësaj kontrate do të konsiderohen rreziqe të përjashtuara dhe Siguruesi nuk do të mbulojë humbjen e jetës së të Siguruarit në rast se humbja e jetës vjen si pasojë direkte apo indirekte e:

1. Pasojave të infektimit me virusin HIV, respektivisht SIDA, (Sindromi i Defiçiences Imunitare të Fituar);
2. Luftës, veprimeve të armikut të jashtëm, armiqësive/luftimeve (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftës civile. Mbulimi mbetet i vlefshëm për qëndrimin jashtë shtetit për një periudhe 15 ditore me kusht që shteti i huaj në kohën e nisjes së të siguruarit nuk ka këshilluar udhëtarët përmes autoriteteve kompetente, që të mos shkojnë drejt këtij shteti, si dhe me kusht që i siguruari nuk ka marrë pjesë në trazirat.
3. Rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes. Vdekja e të siguruarit nuk mbulohet nëse vdekja ndodh si pasojë e pjesëmarrjeve direkte ose indirekte në luftë, kryengritje apo trazira civile në përgjithësi, përveçse në rast të mbrojtjes së ligjshme ose në rast se i siguruari është anëtar i trupës përgjegjëse për ruajtjen e sigurisë publike dhe sulmohet nga kryengritësit.
4. Akteve terroriste të lidhura me terrorizmin bërthamor, kimik dhe biologjik;
5. Aksidenteve të ndodhura nga reaksionet nukleare, radioaktiviteti, rrezatimi jonik dhe pranisë së lëndës radioaktive, produkteve radioaktive apo mbetjeve të tyre.
6. Akteve të qëllimshme të policëmbajtësit ose të një apo më shumë përfituesve apo si rrjedhojë e akteve të nxitura nga njëri prej tyre në dëm të interesave të të siguruarit.
7. Vdekjes si pasojë e ndodhjes së të siguruarit nën influencën e alkoolit, përdorimit të drogës, intoksikantëve të çdo lloji apo abuzimit me medikamentet e përshkruara nga mjeku;
8. Aksidenteve të ndodhura në kushtet e paaftësisë mendore.
9. Vetëvrasjes apo tentativës për vetëvrasje të të siguruarit.
10. Aksidenteve të ndodhura në kushtet e veprimeve të dhunës, përvecse në rast të vetëmbrojtjes së ligjshme, shpëtimit apo përpjekjeve për shpëtimin e personave apo pronave në rrezik;
11. Aksidenteve të ndodhura nga veprimet e papërgjegjshme;

12. Pjesëmarrjes së të siguruarit në kryerjen e një krimi apo shkeljeje, e kryer qëllimisht nga i siguruari si autor apo bashkautor dhe rezultatin fatal të cilës i siguruari mund ta parashikonte;
13. Aksidentet e ndodhura në kushtet e ekspozimit të vullnetshëm ndaj rrezikut te veçantë dhe të panevojshëm;
14. Aksidentet e ndodhura gjatë garave apo stërvitjes me mjete apo pajisje ku shpejtësia është një element mbizotërues;
15. Aksidentet e ndodhura nga ushtrimi i sporteve me qëllime përfitimi;
16. Aksidentet e ndodhura si pasojë e sporteve të ndeshjes, alpinizmit, ngjitjes në terren, scuba diving, eksplorimit të shpellave, parashutizmi, hand-gliding, regbi (rugby), gjuetisë, polo, kaskasave, hockey në akull, paragliding, glider, ultralight, hedhjes me litar elastik (Jumb Benji), rafting, ski jashtë pistës, hedhjes nga lartësitë (base jumping);
17. Udhëtimit të të siguruarit me çdo mjet fluturimi, përveç se kur udhëton si pasagjer (dhe jo si anëtar i ekuipazhit), në një mjet fluturimi që është i autorizuar për transportin e pasagjerëve;
18. Sporteve të rrezikshme si sporteve motorike, zhytjes, alpinizmit të çdo lloji, hedhje e lirë nga lartësi me ose pa motor, parashutizmi (përveçse ne rast të forcave madhore), artet marciale, kanotazhi i çdo lloji, hedhjes nga lartësi të mëdha duke qenë i lidhur;
19. Përfshirjes së të Siguruarit në veprimtari të paligjshme apo kriminale, akte kriminale e keqëdashëse nga persona me të cilët i Siguruari ka konflikte të mëparshme, ose kur sigurimi kryhet në rrethana të paramenduara që favorizojnë pagesën e dëmit;
20. Në rast vdekjeje, përfituesi nuk do të paguhet në rast se kufoma nuk gjendet apo është e paidentifikueshme, përvecse sa parashikohet në pikën 4 të Nenit 7;
21. Nëse vdekja e të Siguruarit është pasojë e një tërmeti, katastrofe natyrore apo çdo fenomen natyror i këtij klasifikimi.

VI. DETYRIMET E POLICËMBAJTËSIT

Neni 13
Pavlefshmëria e kontratës së sigurimit

1. Deklarimet e të Siguruarit dhe/ose të Kontraktuesit duhet të jenë të sakta dhe të plota.
2. Nëse pas lidhjes së kontratës së sigurimit del se i Siguruari ka bërë deklarime të pasakta apo ka mbajtur të fshehtë informacione të tilla, për të cilat Siguruesi nuk do të kishte dhënë pëlqimin për të lëshuar Policën e Sigurimit ose nuk do ta kishte lëshuar me të njëjtat kushte nëse do të dinte gjëndjen e vërtetë të fakteve, Siguruesit i lind e drejta:

   2.1 Në rast se deklarimet e pasakta janë bërë me dashje apo i Siguruari ka qënë në dijeni të informacioneve të cilat i ka mbajtur të fshehta:
   a. Të zgjidhë kontratën e sigurimit në çdo kohë duke filluar nga data që njihet me deklarimet e pasakta apo fshehjen e fakteve. Në rast se kontrata zgjidhet për këtë shkak, atëherë Siguruesi ka të drejtë të mbajë primin e sigurimit që i përket periudhës së sigurimit deri në zgjidhjen e kontratës.
   b. Të refuzojë pagesat në rast se vërtetohet ngjarja e sigurimit në çdo kohë.

   2.2 Në rast se deklarimet e pasakta janë bërë pa dashje:
   a. Të tërhiqet nga kontrata në çdo kohë duke filluar nga data që u njoh me deklarimet e pasakta ose fshehjen e fakteve. Në rast se kontrata zgjidhet për këtë shkak, atëherë Siguruesi ka të drejtë të mbajë primin e sigurimit që i përket periudhës së sigurimit deri në zgjidhjen e kontratës.
   b. Të reduktojë në rast dëmi dhe në çdo kohë shumën e sigurimit nëse është vërtetuar një risk më i lartë për të cilin i Siguruari duhet të paguajë një prim më të lartë.
   c. Të refuzojë në rast dëmi dhe në çdo kohë, pagesën e shumës së sigurimit, nëse Sigururesi nuk do ta kishte nënshkruar kontratën po të ishte në dijeni të gjëndjes së vërtetë të fakteve. Primet e paguara i mbeten Siguruesit.

Neni 14
Deklarimi i pasaktë i moshës

1. Kontrata e sigurimit do të jetë e pavlefshme dhe Siguruesi detyrohet të kthejë primin e paguar nëse në çastin e lidhjes së kontratës, mosha e të Siguruarit është paraqitur pasaktësisht dhe mosha e vërtetë e të Siguruarit është jashtë limitit maksimal të moshës për sigurimin e përcaktuar nga Siguruesi.

Neni 15
Informimi i siguruesit

1. Pas lidhjes së kontratës së sigurimit, Kontraktuesi/i Siguruari detyrohet të verë në dijeni Siguruesin mbi të gjitha faktet dhe rrethanat e rëndësishme për vlerësimin e rrezikut që Kontraktuesi/i Siguruari di apo që duhej të dinte. Çdo rrethanë mbi të cilën Siguruesi ka shtruar një pyetje në aplikimin për sigurim do të quhet rrethanë e rëndësishme në sigurim.
2. I siguruari detyrohet të njoftojë Siguruesin për çdo ndryshim të rrethanave personale përgjatë periudhës së kontratës (si ndryshime në rezidencë, (nëse do të jetojë për më shumë se 2 muaj në çdo 12 muaj kalendarikë jashtë Shqipërisë), ndryshime në profesion/punën aktuale).

VII. RIAKTIVIZIMI I KONTRATËS SË SIGURIMIT

Neni 16
Përfundimi përpara kohës, riaktivizimi i policës

1. Në rast se sigurimi ka përfunduar përpara kohës së përcaktuar në policë mund të ripërtërihet me anë të një kërkese me shkrim nga Kontraktuesi/i Siguruari brenda 12 muajve nga përfundimi i muajit të fundit që primi është paguar.

VIII. E DREJTA E SIGURUESIT PËR TË KËRKUAR RIMBURSIM TË PËRFITIMIT TË PAGUAR

Neni 17
Dëmshpërblimi nga palët e treta

Siguruesi pasi ka paguar shumën e sigurimit në favor të Përfituesit, ka të drejtën për të kërkuar rimbursim të shumës së paguar nga një palë e tretë shkaktare e ngjarjes së sigurimit deri në vlerën e shumës së paguar si përfitim si dhe në rast se ka, shpenzimet e nevojshme gjyqësore apo shtesa të tjera. Përfituesi i cili ka marrë shumën e siguruar nga Siguruesi nuk ka të drejtë ta kërkojë atë edhe nga një palë e tretë shkaktare e dëmit.

IX. TË DREJTAT MBI SIGURIMIN E JETËS

Neni 18
Të drejtat që rrjedhin nga kontrata e sigurimit

1. Të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kontrata e sigurimit i përkasin Kontraktuesit/të Siguruarit deri në ndodhjen e ngjarjes së sigurimit.

X. NGJARJA E SIGURIMIT

Neni 19
Njoftimi i ngjarjes së sigurimit

1. Përfituesi detyrohet që me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit të njoftojnë me shkrim Siguruesin brenda 15 ditësh nga dita e ngjarjes. Siguruesi nuk mund të pretendojë mosplotësim të këtij kushti, nëse policëmbajtësi dhe/ose përfituesi provon se njoftimi është bërë në kohën më të shpejtë të mundshme dhe të arsyeshme.
2. Njoftimi bëhet me formularin përkatës të Siguruesit dhe bashkë me të paraqiten edhe dokumentat:

   i. Origjinali i policës së sigurimit të jetës;
   ii. Kopje të dokumentit të identifikimit të përfituesit;
   iii. Çertifikatën e vdekjes ose dokument tjetër që vërteton vdekjen e të Siguruarit;
   iv. Raporti mjekësor për datën, kohën, vendin , rrethanat dhe shkaqet e vdekjes, etj
   v. Epikrizë mjekësore nga mjeku që e ka kuruar ose mjekuar të ndjerin;
   vi. Dokumenta të tjerë mjekësorë dhe ligjorë nëse është e nevojshme;
   vii. Dëshmi trashëgimie nëse si përfitues të policës janë përcaktuar trashëgimtarët e ligjshëm;

3. Siguruesi ka të drejtë të kërkojë dhe prova të tjera të nevojshme për vërtetimin e të drejtës për pagesë.

XI. PAGESA E SHUMËS SË SIGURIMIT

Neni 20

Pagesa e shumës e sigurimit

1. Siguruesi paguan shumën e sigurimit në përputhje me kontratën brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita që ka marrë njoftimin e ngjarjes së sigurimit dhe dorëzimit të të gjithë dokumentave dhe provave të parashikuara në KUSHTE.
2. Siguruesi kërkon që para pagesës së shumës së sigurimit të nënshkruhet një deklaratë nga i përfituesi, në të cilën konfirmohet plotësimi i sigurimit.

XII. PËRCAKTIMI I PËRFITUESIT

Neni 21

Përcaktimi i përfituesit

1. Kontraktuesi/i Siguruari përcakton në kontratë përfituesin e shumave të pagueshme që rrjedhin nga kontrata. Në të kundërt, zbatohen dispozitat e Kodit Civil mbi trashëgiminë.

XIII. LËSHIMI I POLICËS ZËVENDËSUESE

Neni 22

Lëshimi i dublikatës

1. Në rast humbje të policës së sigurimit, atëherë Kontraktuesi/i Siguruari detyrohet të njoftojë menjëherë Siguruesin për humbjen e saj.
2. Siguruesi do të lëshojë një kopje të saj kundrejt lëshimit të një deklarate noteriale nga Kontraktuesi/i Siguruari ku deklarohet se polica e sigurimit ka humbur dhe nuk është përdorur për ndonjë qëllim tjetër.
3. Të gjitha shpenzimet e nevojshme për lëshimin e policës zëvendësuese do të përballohen nga Kontraktuesi/i Siguruari.

XIV. PAGESA E DETYRIME TË TJERA

Neni 23

Pagesa për shërbimet

1. Siguruesi gëzon të drejtën që t'i kërkojë Kontraktuesit/të Siguruarit të paguajë për të gjitha shërbimet që ky i fundit kërkon në veçanti nga Siguruesi. Pagesa për shërbimet do të jetë një vlerë e përcaktuar nga Siguruesi.
2. Përfituesi/I siguruari detyrohet të paguajë të gjitha detyrimet e parashikuara në legjislacionin tatimor në fuqi.

XV. REZIDENCA DHE TERRITORIALITETI

Neni 24

Rezidenca

Rezidenca e përhershme e të siguruarit, duhet të jetë në Shqipëri.

Neni 25

Territorialiteti

1. Në rast se i siguruari udhëton jashtë Shqipërisë për një periudhë kohe maksimumi 2 muaj gjatë një viti, ai është automatikisht i mbuluar nga kjo policë sigurimi.

XVI

NDRYSHIME

Neni 26

Ndryshimi i Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit

Këto Kushte të Përgjithshme të Sigurimit mund të zëvendësohen apo të ndryshohen me miratimin e një aktuari, dhe pas vënies në dijeni të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, ndryshime për të cilat Kontraktuesi/i Siguruari duhet të njoftohet plotësisht e saktësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi.

XVII. JURIDIKSIONI DHE MONEDHA

Neni 27

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, monedha e kontratës

1. Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve të kontratës së sigurimit është Gjykatat e Rrethit Tiranë, përveç rasteve kur është vendosur ndryshe.
2. Monedha për të gjitha veprimet e parashikuara në këtë kontratë është monedha në të cilën përcaktohet dhe llogaritet shuma e sigurimit.

XVIII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 28

Legjislacioni i zbatueshëm

1. Për çdo rregullim të marrëdhënieve midis Siguruesit, të siguruarit, kontraktuesit, përfituesit dhe personave të tjerë, për të cilët nuk shprehen këto kushte, janë të zbatueshme parashikimet e Kodit Civil.
2. Siguruesi në kuadër të kësaj kontrate mbledh, ruan depoziton dhe përdor të dhënat personale të nevojshme për nënshkrimin e policës së sigurimit, në respektim të dispozitave të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), si dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, legjislacionit tatimor për te ardhurat personale etj..